

Sqarim:

Dhënia e shënimive shpjeguese në këtë pjesë është e detyrueshme sipas SKK 2.

Plotesimi i te dhenave të kësaj pjese duhet të bëhet sipas kërkesave dhe strukturës standarde te percaktuara ne SKK 2. Rradha e dhenies se shpjegimeve duhet te jetë :

- a) Informacion i përgjithshëm dhe politikat kontabël
- b) Shënimet qe shpjegojnë zërat e ndryshëm të pasqyrave financiare
- c) Shëнимi të tjera shpjeguese

A I Informacion i përgjithshëm

- 1 Kuadri ligjor: Ligji 25/2018 dt 10.05.2018 "Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" I ndryshuar
 - 2 Kuadri kontabel i aplikuar : Standartet Kombetare te Kontabilitetit ne Shqiperi.(SKK 2)
 - 3 Baza e pergatitjes se PF : Te drejtat dhe detyrimet e konstatuara.(SSK 1)
 - 4 Parimet dhe karakteristikat cilesore te perdonura per hartimin e P.F. : (SKK 1;)
 - a) NJESIA EKONOMIKE RAPORTUSE ka mbajtur ne llogarite e saj aktivet,pasivet dhe transaksionet ekonomike te veta.
 - b) VIJIMESIA e veprimtarise ekonomike te njesise sone raportuse eshte e siguruar duke mos pasur ne plan ose nevoje nderprerjen e aktivitetit te saj.
 - c) KOMPENSIM midis nje aktivi dhe nje pasivi nuk ka , ndersa midis te ardhurave dhe shpenzimeve ka vetem ne rastet qe lejohen nga SKK.
 - d) KUPTUSHMERIA e Pasqyrave Financiare eshte realizuar ne masen e pote per te qene te qarta dhe te kuptushme per perdonues te jashtem qe kane njohuri te per gjitheshme te mjaftueshme ne fushen e kontabilitetit.
 - e) MATERIALITETI eshte vleresuar nga ana jone dhe ne baze te tij Pasqyrat Financiare jane hartuar vetem per zera materiale.
 - f) BESUSHMERIA per hartimin e Pasqyrave Financiare eshte e siguruar pasi nuk ka gabime materiale duke zbatuar parimet e me poshteme :
- Parimin e paraqitjes me besnikeri
 - Parimin e perparese se permbajtjes ekonomike mbi formen ligjore
 - Parimin e paaneshmerise pa asnje influencim te qellimshem
 - Parimin e maturise pa optimizem te tepueruar,pa nen e mbivleresim te qellimshem
 - Parimin e plotesise duke paraqitur nje pamje te vertete e te drejte te PF.
 - Parimin e qendrushmerise per te mos ndryshuar politikat e metodat kontabel
 - Parimin e krahasushmerise duke siguruar krahasimin midis dy periudhave.

A II Politikat kontabël

Per percaktimin e kostos se inventareve eshte zgjedhur metoda "Fifo"

(SKK 4:)

Vleresimi fillestari i nje elementi te AAM qe ploteson kriteret per njohje si aktiv ne bilanc eshte vleresuar me kosto. (SKK 5;)

Per prodhimin ose krijimin e AAM kur kjo financohet nga nje hua,kostot e huamarrjes (dhe interesat) eshte metoda e kapitalizimit ne koston e aktivit per periudhen e investimit.(SKK 5)

Per vleresimi i mepaseshem i AAM eshte zgjedhur modeli i kostos duke i paraqitur ne bilanc me kosto minus amortizimin e akumuluar. (SKK 5;)

Per llogaritjen e amortizimit te AAM (SKK 5) njesia jone ekonomike ka percaktuar si metode te amortizimit te ndertesave metoden lineare dhe per AAM te tjera metoden e amortizimit mbi bazen e vletes se mbetur ndersa normat e amortizimit jane perdonur te njellojta me ato te sistemit fiskal ne fuqi dhe konkretisht :

Ndertesa me 5% te vleres

- Kompjutera e sisteme informacioni me 25 % te vletes se mbetur
- Te gjitha AAM te tjera me 20 % te vletes se mbetur

Per llogaritjen e amortizimit te AAJM (SKK 5) njesia ekonomike raportuese ka percaktuar si metode te amortizimit metoden lineare ndersa normen e amortizimit me 15 % ne vit.

0

